



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dituruar Primijsni/Prodato Received/Delivered	13.02	2023	3	viti god. year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKINSHIK	1730/2023		116	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1312/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Sabile Avdyli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1312/2022 të datës 29.12.2022, të parashtruar nga ankuesja [blank] përmes përfaqësuesit me autorizim, Avokati [blank] nga Ferizaj, kundër Vendimit me nr.07-030/01-15397/2022 të datës 22.11.2022 të Komisionit Disiplinor në Komunën e Shtërpcës, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 13.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1312/2022 e datës 29.12.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Anulohet Vendimi me numër 07-030/01-15397/22 i datës 22.11.2022 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Shtërpcës dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te Komisioni Disiplinor i Komunës së Shtërpcës.
- III. Obligohet Komisioni Disiplinor i Komunës së Shtërpcës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmar të gjitha veprimet ligjore për zbatimin e këtij vendimi ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Shtërpcës që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja _____, e punësuar në Komunën e Shtërpçës sipas Akt emërimit të datës 01.01.2012, në pozitën „Referente për listë poseduese “më datë 27.12.2022 përmes postës ka parashtruar ankesë me numër protokollit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me datën 29.09.2022 nën shenjën A.nr.1312/2022 me numër protokollit 8585/2022, kundër Vendimit me nr. 07-030/01-15397/22 i datës 22.11.2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtërpçës, për shkak të paligjshmërisë së inicimit të procedurës disiplinore, shkelje e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe shkelje e Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.01.2023 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Komuna e Shtërpçës. Ndërsa Këshilli më datë 20.01.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 8585/2022 të datës 29.12.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me nr. 07-030/01-15397/22 i datës 22.11.2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtërpçës; Procesverbal i datës 25.11.2022 me nr.02-030101-15772/22 i seancës të Komisionit Disiplinor; Akt emërimi i datës 01.01.2012; Përshkrimi i detyrave të punës ; Kërkesë për udhëheqësin e shërbimit për kuadra; Raporti mjekësor i datës 18.08.2022; Autorizim i datës 05.12.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 10.01.2023 me numër protokollit 121/2023; Përgjigje në ankesë e datës 20.01.2023 nga organi i punësimit me numër protokollit 622/2023 bashkë me shkresat e lëndës; Njoftimi për procedurën disiplinore të supozuar të datës 15.11.2022 me nr.07-030-01-15397/22; Kërkesë për informata të datës 31.10.2022 në Policinë e Kosovës dhe Përgjigje në kërkesë e datës 31.10.2022 me nr.07-941/01-14786/22 nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe pronë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ndaj ankuses e punësuar në Komunën e Shtërpçës, sipas Akt Emërimit të datës 01.01.2012 në pozitën „Referente për Listë Poseduese“, me datë 15.11.2022 Drejtoresha e Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronës ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 07-030-01-15379/22 për

inicimin procedurës disiplinore ndaj Bojana Dobrosavljevic me detyre „Referente për Listë Poseduese” ne Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Shtërpcës ka konstatuar se pas pranimit të kërkesës me numër të protokollit 07-030-01-15379/22 të datës 15.11.2022 të parashtruar nga Drejtoresha e Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronës, ka shqyrtuar rastin e ankueses dhe me datë 22.11.2022 nxjerr Vendim me numër protokollit 02-030101-15772/22 me të cilin vendim ankueses Bojana Dobrosavljevic i shqipton masën disiplinore “ Suspendim nga puna për një periudhë 3 mujore dhe ndalimi i pagesës në pagë prej 20% për tre muajt’.

Ankuesja përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokollit 02-030101-15772/22 të datës 22.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtërpcës, me pretendime ankimore se Komisioni Disiplinor nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore, gjegjësisht nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe juridike, po ashtu ajo pretendon se Komisioni Disiplinor ka bërë shqiptimin e masës disiplinore ne kundërshtim me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative për faktin që vendimi i kontestuar nuk përmban asnjë bazë ligjore mbi të cilën është mbështetur, nuk përmban arsyetimin dhe nuk përmban saktë udhëzimin për mjetin juridik dhe afatin, po ashtu ajo thekson se nuk janë vlerësuar elementet e përgjegjësisë disiplinore .

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit ka konstatuar se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 02-030101-15772/22 të datës 22.11.2022 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat që përcaktojnë procedurën disiplinore përkatësisht në kundërshtim me nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se: “Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t’u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit ” sepse ne rastin konkret Kolegji i Këshillit ka konstatuar se në bazë të provave të lëndës, në seancë të Komisionit Disiplinor të mbajtur më datë 21.12.2022 është ftuar vetëm ankuesja, ndërsa iniciuesja e procedurës disiplinore nuk ka qenë prezent në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor, andaj në këtë rast Kolegji i Këshilli, konstaton se mos ftesa e iniciuesit të procedurës disiplinore është shkelje e këtij neni për faktin që pa marr parasysh kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore iniciuesi i procedurës disiplinore duhet të ftohet në seancë të komisionit disiplinor dhe përveç kësaj, duhet të jenë njëkohësisht në seancë bashkë me nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore me qëllim që të paraqesin argumentet e tyre.

Lidhur me përgjegjësin disiplinore, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, i’u referua nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”. Ndërlidhur me këtë në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, janë kualifikuar shkeljet e

rënda të detyrave të punës: "Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë". Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar".

Andaj gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë të masës disiplinore të shqiptuar ndaj ankueses, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që Komisioni disiplinor masën disiplinore „ Suspendim nga puna për një periudhë 3 muajore dhe ndalimi i pagesës në pagë prej 20% për tre muaj ’ ndaj ankueses e ka shqiptuar pa e vlerësuar drejtë natyrën e shkeljes së supozuar nga ana e ankueses, gjegjësisht shkeljen e ankueses e ka cilësuar vetëm që është shkelje e sanksionuar me nenin 46 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, pa e cilësuar se a përbën shkelje të lehtë apo shkelje të rënda. Po ashtu Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht neni 47, ka përcaktuar se: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil", ku për shkelje të lehta jepen masa disiplinore të përcaktuara me nën paragrafin 1.1 të nenit 47 ndërsa për shkelje të rënda jepen masat disiplinore të përcaktuara me nën paragrafët 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji. Në rastin konkret të ankueses Komisioni Disiplinor i Komunës së Shtërpcës, përmes Vendimit me nr. 07-030/01-15397/22 të datës 22.11.2022 i ka shqiptuar "suspendim nga puna për një periudhë 3 muajore dhe ndalimi i pagesës në pagë prej 20% për tre muaj", si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankueses i janë shqiptuar dy masa disiplinore , andaj me rastin e shqyrtimit të masës disiplinore Komisioni ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 50 paragrafit 5 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore.,

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Shtërpcës me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër protokoll 02-030101-15772/22 të datës 22.11.2022, me të cilin i ka shqiptuar ankueses masën disiplinore „ Suspendim nga puna për një periudhë 3 muajore dhe ndalimi i pagesës në pagë prej 20% për tre muaj ” ka vepruar në kundërshtim me nenin 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, i cili përcakton se „Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. „Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura” dhe 1.2. Përcakton

dhe shqipton masën disiplinore'' dhe në kundërshtim me nenin 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik ku përcaktohet se; „Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 4.1. Shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 4.2. Shkallën e fajësisë; 4.3. Ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të Ligjit; 4.4. Përpyekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit'' sepse në rastin konkret Komisioni nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë provat dhe faktet, nuk ka bërë administrimin e provave mbi bazë të cilave është vendosur për masën e shqiptuar, nuk ka marrë për bazë deklarin e ankueses, nuk e ka ftuar në seance inicuesen e procedurës disiplinore, respektivisht nuk ka arritur të konstatoj saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore siç parashihet me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht Vendimi me nr.02-030101-15772/22 i datës 22.11.2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtërpcës, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 dhe me nenin 48 paragrafi 2 që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, sepse rrjedhimisht vendimi nuk arsyeton gjendjen faktike dhe bazën juridike siç përcaktohet më Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse vendimi i lartë cekur nuk përmban dispozitiv të qartë, përmban vetëm formulime të përgjithshme, po ashtu mungon arsyetimi me i detajuar se me cilat veprime apo mos veprime ankuesi ka bere shkelje të detyrave të punës, si dhe i mungon këshilla juridike.

Nga të lartcekurat, Kolegji i Këshillit, meqenëse konstatoj se Vendimi me nr.02-030101-15772/22 të datës 22.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtërpcës, është nxjerr si rezultat i shkeljeve procedurale, atëherë i njëjti sipas Kolegjit të Këshillit është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që në kuptim të dispozitave ligjore përkatësisht nenit 48 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publik, nenit 11 dhe 13 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, Komisioni Disiplinor ka mandat të dëgjoj dhe shqyrtoj provat në lidhje me shkeljen e supozuar dhe që në bazë të provave të prezantuara të vendos nëse është kryer shkelja e supozuar si dhe të përcaktojë masën disiplinore, andaj Komisioni Disiplinor me rastin e rishqyrtimit të rastit disiplinor të inicuar ndaj nëpunëses është i obliguar që të vlerësoj të gjitha provat e bashkëngjitura të lëndës, duke marrë parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese, si dhe të vendos për shqiptimin e masës disiplinore në proporcion me shkeljen e kryer, në pajtim me nenin 50 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës si dhe dispozitat përkatëse ligjore dhe nënligjore për procedurën dhe masat disiplinore në shërbimin civil, respektivisht të nxjerr vendim meritor për nëpunësen civile Bojana Dobrosavljevic.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.




Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1312/2022

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi Bajraktari



Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Avokatit te ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Shtërpcës;
- Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtërpcës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Shtërpcës; dhe
- Arkivit të KPMShCK- së;